

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2019

PERCEPTIMI I ABSOLVENTËVE TË INFERMIERISË TË KOLEGJIT UBT PËR KOMPETENCAT E TYRE PËR TREGUN E PUNËS

Jona Vuqetërna

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Nursing Commons](#)



Kolegji UBT

Fakulteti i Infermierisë

PERCEPTIMI I ABSOLVENTËVE TË INFERMIERISË TË KOLEGJIT
UBT PËR KOMPETENCAT E TYRE PËR TREGUN E PUNËS

Shkalla Bachelor

JONA VUQETËRNA

Dhjetor, 2019

Prishtinë



Kolegji UBT

Fakulteti i Infermierisë

PUNIM DIPLOME

2016 - 2017

JONA VUQETËRNA

TITULLI I TEMËS: PERCEPTIMI I ABSOLVENTËVE TË INFERMIERISË TË KOLEGJIT UBT PËR KOMPETENCAT E TYRE PËR TREGUN E PUNËS

Mentori: Dr. DUGAGJIN SOKOLI

DHJETOR 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKTI

Arsimi klinik mund të definohet si akt që ndihmon studentët të fitojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e kërkuara në klinikë, rregullat e praktikës për të përmbushur standardet ashtu siç janë të përcaktuara nga një bord profesional (Rose 2005). Ndërsa perceptimi ndikon në mënyrën se si mendojmë për detyrat që kryejmë dhe si ne ndryshojmë dhe përmirësojmë ato detyra për të kryer një punë (Dewey, 1997).

Synimi kryesor i këtij hulumtimi është të gjejmë dhe të përshkruajmë perceptimin e absolventëve të fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT rreth nivelit të përgaditjes së tyre për tregun e punës. Në këtë hulumtim morën pjesë 71 absolvent të fakultetit të infermierisë në Kolegjin UBT, ku prej tyre 67 ishin femra ndërsa 4 prej tyre ishin meshkuj, të moshës mesatare 22.07 vjeç. Të dhënat janë grumbulluar me anë të pyetësorit të vetë-dizajnuar i përshtatur për fushën e infermierisë dhe është lansuar me anë të google forms.

Bazuar nga rezultatet e fituara nga ky hulumtim, absolventët e Fakultetit të Infermierisë të kolegjit UBT kanë njohuri të mjaftueshme për çështjet që i trajton fusha e infermierisë. Praktikrat e zhvilluara gjatë këtyre tri viteve akademike sipas tyre janë mesatarisht të mjaftueshme. Ndërsa sa i përket perceptimit të tyre se sa ndihen të përgatitur të dalin në treg të punës pasi të diplomojnë shumica e studentëve ndihen të përgatitur mjaftueshëm. Niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermieria ka ndërlidhje me atë se sa ndihen të përgatitur të dalin në treg të punës studentët pas diplomimit ($r=.287$, $p=.015^*$). Gjithashtu niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermieria dhe fakti se sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktike gjatë këtyre tre viteve të studimeve ndikojnë atë se sa ndihen të përgatitur $p=.000$.

FJALËT KYÇE: Arsimi klinik, praktika, absolventët, perceptimi.

MIRËNJOHJET/FALENDERIMET

Fillimisht i falënderohem Zotit që më ka ofruar të gjitha mundësitë e më pas familjen time për përkrahjen e vazhdueshme, gjithashtu falënderoj edhe të dashurin i cili më qëndroi pranë gjatë rrugëtimit tim të deritanishëm.

Kjo temë diplome është një punim akademik, si rezultat i përkushtimit dhe i përfundimit të studimeve të mia. Është e natyrshme që për të realizuar gjithë këto duhet kohë dhe mund, por është e rëndësishme të shprehësh mirënjohje ndaj individëve që shpenzojnë kohën e tyre për të ofruar ndihmë.

Falënderoj mentorin e temës, Dr. Dugagjin Sokoli, i cili me ndihmën dhe konsulencën e tij profesionale më ofroi orientimin e duhur. Si dhe absolventët e fakultetit të Infermierisë të Kolegjit UBT të cilët ndihmuan në realizimin e këtij hulumtimi.

Dua ta falënderoj edhe shoqërinë për mbështetjen dhe këshillat që më përcollën në çdo hap!

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE.....	VI
LISTA E TABELAVE.....	VI
1. HYRJA.....	7
2. SHQYRTIMI I LITERATURES.....	10
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	12
3.1 Objektivat hulumtuese	12
3.2 Synimi kryesor	12
3.3 Hipotezat.....	13
4. MATERIALI DHE METODAT.....	14
4.1 Konceptualizimi i hulumtimit.....	14
4.2 Mostra	14
4.3 Instrumenti.....	15
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE.....	16
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	23
REFERENCAT.....	24
SHTOJCAT.....	26

LISTA E FIGURAVE

Figura 1:Njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri.....	16
Figura 2:. Praktikant e zhvilluara gjatë këtyre tre viteve akademike.....	16
Figura 3:Sa ndiheni të përgaditur të dilni në treg të punës pas diplomimit?.....	17

LISTA E TABELAVE

Tabela 1:Statistika deskriptive për moshën.....	14
Tabela 2:Statistika deskriptive për gjininë.....	14
Tabela 3:Analiza e Cronbach's Alpha.....	15
Tabela 4:Statistika deskriptive e reparteve.....	18
Tabela 5:Statistika deskriptive e intervenimeve.....	19
Tabela 6:Analiza e korrelacionit.....	20
Tabela 7:Analiza e regresionit.....	21
Tabela 8:Analiza e Anovës.....	21
Tabela 9:Analiza e Anovës2.....	22

1. HYRJA

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, popullsia në Kosovë për vitin 2018 vlerësohet të jetë 1,795,666 banorë rezident. Gjatë vitit 2018 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore për 18,562 ose 1.02%. Në këtë vit është vlerësuar se 8,967 persona ndërruan vendbanimin (komunën) e tyre kurse 6,762 persona imigruan (përfshirë të kthyerit) në Kosovë derisa numri i emigrimit ishte dukshëm më i lartë ku 28,164 persona emigruan nga Kosova. Gjatë viteve 2017-2018, nga ASK gjithashtu kuptohet se rreth 55 mijë banorë janë analfabet të plotë, ndërsa rreth 82 mijë janë analfabet funksional.

Një analfabet është i plotë, kur nuk di fare shkrim dhe lexim, si dhe funksional kur di të shkruaj mirëpo nuk e kupton atë. Analfabetizmi si dukuri është i pranishëm gjithandej nëpër botë. Në nivel global, numri i personave të rritur që vazhdojnë të mos dinë shkrim e lexim mbërrin 774 milionë në gjithë botën, që është numër ende shumë i madh. Nga kjo shifër, 123 milionë veta janë të rinj të moshës 15 deri në 24 vjeçare. Dy të tretat e analfabetëve, sipas UNESCO-s janë femra. Vendet me shkallë më të lartë të analfabetizmit janë disa shtete afrikane në jug të Saharës dhe disa shtete aziatike.

Sipas një studimi nga Instituti i Vienës për Studimet Ndërkombëtare në Ekonomi në vitin 2018, papunësia ndër të rinjtë është një çështje shqetësuese pothuajse në të gjitha vendet në tranzicion. Norma e papunësisë për personat e moshës deri në 24 vjeç në vendet e Ballkanit është përafërsisht dy deri në tri herë më e lartë se sa norma e përgjithshme e papunësisë dhe kjo normë është prej 18% dhe 20.8% në Slloveni dhe Rumani respektivisht deri në 68.6% në Maqedoninë Veriore. Pesëmbëdhjetë viteve të fundit papunësia për të rinjtë e moshës deri në 29 vjeç përbënë rreth 50% të të papunëve në disa vende. Në Shqipëri rreth 58% e të papunëve janë deri në moshën 31 vjeçare derisa në Kroaci rreth 53.9% e të papunëve janë deri në këtë moshë.

Femrat përbëjnë më shumë se 50% të të papunëve me edukim të ulët (pa edukim ose vetëm me edukim fillor). Fakti që shumica e vendeve të lira të punës për persona me edukim të ulët plotësohen nga meshkujt (pasi këto janë punë që kërkojnë aftësi fizike, siç janë punët në ndërtimtari etj.), mund të jetë njëra nga spjegimet për dominimin e femrave në grupin e të

papunëve me edukim të ulët. Përveç kësaj, kjo situatë rezulton edhe nga fakti se femrat në përgjithësi janë më pak të shkolluara se meshkujt (WBG, 2018).

Sipas Institutit për Hulumtime Zhvillimore, Riinvest, në vitin 2003 theksuan se tregu i punës në Kosovë ka disa karakteristika të veçanta krahasuar me vendet e tjera në tranzicion. Pothuaj të gjitha të dhënat që janë në dispozicion tregojnë se një e treta e popullsisë është nën moshën 16 vjeçare dhe mbi 50% e popullsisë është deri në 24 vjeç. Studimet ekonometrike të kryera në disa vende në tranzicion kanë treguar se personat me edukim të ulët kanë gjasa më të mëdha që të bëhen të papunë. Megjithatë ka diferenca në mes vendeve dhe brenda një vendi, por në përgjithësi kjo tendencë duket të jetë karakteristike për të gjitha vendet dhe regjionet. Afërsisht dy të tretat e personave të papunë në vendet në tranzicion posedojnë edukim të mesëm dhe një e treta edukim fillor, derisa në vendet e industrializuara ekziston një shpërndarje më e barabartë e personave të papunë sipas niveleve të edukimit. Kosova nuk përbën një përjashtim, ku 58% e të papunëve posedojnë edukim të mesëm dhe 33% janë me edukim fillor.

Për sa i përket politikave të punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) luan një rol kyç. Një prej prioriteteve të Ministrisë duket se është krijimi i një sistemi të përshtatshëm të shërbimeve të punësimit. Përveç Ministrisë disa partnerë të tjerë janë përfshirë në dhënien e shërbimeve për të papunët. Krahas sistemit të zyrave rajonale të punës (ZRP), në Kosovë janë ngritur gjithashtu edhe një numër qendrash trajnimi profesional (QTP). Pavarësisht se këto qendra janë hapur dhe funksionuar si rezultat i mbështetjes së donatorëve, MPMS mbikqyrë aktivitetet e këtyre qendrave nëpërmjet Departamentit të Punës dhe Punësimit në Ministri.

Sipas legjislacionit bazë të Republikës së Kosovës, deri tani vetëm dy rregullore janë aprovuar që kanë efekt mbi tregun e punës, Ligji për Pensionet dhe Ligji i Punës. Ligji mbi Asistencën Sociale dhe Ligji mbi të Paftët janë dy drafte tjera që janë në diskutim. Pak mund të flitet për to përderisa nuk bëhen publike. Sidoqoftë, ndikimi i tyre në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore duhet të merret parasysh me një dozë maturie, sidomos kur është fjala për atë të mëparshmin. Niveli i asistencës sociale ka të ngjarë që të ndikojë në vendimin e njerëzve për të hyrë në tregun e punës.

Sistemi arsimor në Kosovë është në reformim e sipër, proces që ka përfshirë çdo nivel të sistemit arsimor. Reformat janë ndërmarrë së bashku me strukturat drejtuese ndërkombëtare dhe kanë të bëjnë me një numër fushash të rëndësishme. Përveç kurikulës (planit mësimor), reforma ka përfshirë edhe strukturën organizative dhe institucionet përkatëse. Struktura e re

organizative 5+4+3 (9 vite arsim i detyrueshëm plus tre vite të arsimit të mesëm të lartë) është duke u implementuar. Arsimi i detyrueshëm për moshat 6 ose 7 deri në 14 vjeçare përbën edhe arsimin bazë (arsimin e ulët të mesëm sipas sistemit të prezantuar nga rregullorja 2002/3 me anë të së cilës u bë zgjatja e arsimit të detyrueshëm deri në 9 vjet). Arsimi i mesëm (arsimi i lartë i mesëm) përfshin moshat nga 15 deri në 17 ose 18 vjeç dhe përbën zakonisht 3 deri në 4 vite për shkollat profesionale dhe artistike.

Kolegji UBT inkurajon zhvillimin e mëtejshëm të procedurave dhe aftësive për kërkim pune nga studentët si dhe forcimin e lidhjeve të tyre me grupin e punëdhënësve. Gjithashtu shpresohet në zhvillimin e lidhjeve me njësinë për këshilla profesionale, e cili është themeluar në Zyret Regjionale për Punësim si mjet për zhvillimin e mëtejshëm të kapacitetve të këtyre zyrave në këtë fushë.

Përgatitja për treg të punës paraqitet si sfidë në vete. Kjo nuk nënkupton vetëm përgatitje profesionale apo njohuri specifike në një fushë të caktuar por edhe shumë mund e angazhim. Përgatitja për treg të punës fillon qysh në mosha të hershme, si nxënës e më vonë edhe si studentë, ngase kjo është koha kur njeriu fillon të përqendrohet intelektualisht dhe si rrjedhojë të njohë kapacitetet e tij intelektuale në profesione të caktuara (Berisha, 2018).

2. SHQYRTIMI I LITERATURES

Gjatë dekadave të fundit, mësuesit, profesorët universitarë dhe të tjerë edukatorë kanë qenë duke eksploruar qasje të ndryshme në mësimdhënie. Këto qasje mundën të përfshihen nën titujt e përgjithshëm të mësimit aktiv dhe të përvojës. Një nga strategjitë më me influencë të mësimdhënies që dalin në dekadat e fundit janë mësimi i bazuar në probleme. Kjo strategji mësimore është përdorur gjerësisht në shkollat mjekësore, si dhe në të tjera shkolla profesionale. Mësimi i bazuar në probleme u lejon nxënësve të mësojnë në një mjedis që stimulon kushtet aktuale të punës sa më saktë që të jetë e mundur (Fink, 2003). Si profesionistë, studentët do të hasin probleme dhe situata të vërteta, të hapura. (Anysia, 2013).

Dëshmitë e kohëve të fundit në literaturë kanë treguar se nxënësit mundën në mënyrë më efektive të mësojnë si t'i analizojnë dhe zgjedhin problemet përmes mësimit të bazuar në probleme, krahasuar me kurikulën tradicionale, "njohurisë së librit" për dy apo më shumë vjet dhe vetëm atëherë duke ecur përpara për të mësuar se si të aplikojnë njohuritë e tyre (Duch, 2001). Stech (1973) dhe kolegët pretendojnë se një pjesë e trajnimit klinik duhet të jetë mësimi i metodave për të sjellë procesin e aftësive profesionale në vetëdije. Me fjalë të tjera, studentët klinikistë duhet të mësohen dhe inkurajohen të jenë të vetëdijshëm për aftësitë e nevojshme për proceset "online" që janë të përfshira në mjedisin terapeutik ballë për ballë me klientët. Koncepti i "njohjes në veprim" mbizotëronte dikur përmes një kuadri që përshkruante proceset dinamike të terapisë (Bond 1999). Është pikërisht kjo ide që mund të ndihmojë në mënyrën më efektive për të mësuar studentët tanë klinikë se si të "bëjnë" terapinë, dhe në mësimin e aftësive të tjera praktike që kërkohen për ndërveprimet ballë për ballë me klientët. Koncepti i "njohjes në veprim" është shumë i ngjashëm me njohuritë e heshtura. Dituria e heshtur gjithashtu vë theksin në të mësuarit nga përvoja e drejtpërdrejtë, duke u përshtatur me mjediset e reja, duke aplikuar njohuri në nivele komplekse dhe duke zgjidhur problemet që mund të lindin në praktikë (Nestor 2001).

Arsimi klinik mund të definohet si akt që të ndihmojnë studentët të fitojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e kërkuara në klinikë, rregullat e praktikës për të përmbushur standardet siç përcaktohet nga një bord profesional akreditues (Rose 2005). Qëllimet e përbashkëta të

edukimit klinik përfshijnë: ndihmën e studentëve në marrjen e njohurive, vlerësimin e njohurive teorike dhe të aplikuara, rafinimin e klinikës, aftësitë, njohja e nxënësve me mjedisin klinik / vendin e punës dhe mësimdhënien e kohës së menaxhimit (Mannix, 2006). Kur studentët krijojnë lidhje të reja me atë që kanë mësuar dhe aplikuar, ajo mund t'u japë atyre një ndjenjë të madhe të fuqisë intelektuale (Fink, 2003).

Në raportet e shekullit të njëzetë filluan të publikoheshin identifikimi i mangësive të shkollave mjekësore për të përgatitur në mënyrë efektive të diplomuarit e tyre për praktikë (Flexner, 1925). Gjatë dy dekadave të fundit sistemet e edukimit mjekësor janë kritikuar për mos arritjen e qëllimeve të tyre, dhe cilësia e edukimit mjekësor është debatuar gjerësisht (Fraser, 1991). Kohët e fundit një raport i lëshuar nga Shoqata e Kolegjeve Amerikane të Mjekësisë i referohej një teme të përsëritur që është manifestuar në shumë raporte të botuara gjatë dekadës së fundit mbi edukimin mjekësor, përkatësisht mungesës së efektivitetit të shkollave mjekësore në përgatitjen e të diplomuarve të tyre për praktikë. Raporti theksoi nevojën për mënyra të reja për të trajnuar mjekët (Komiteti Ad Hoc i Dekanëve, 2001). Për të adresuar këto kritika janë zbatuar shumë projekte; disa kanë identifikuar objektiva specifike dhe rekomandime për shkollat mjekësore (Greenlick, 1995). Të tjerët kanë theksuar se shkollat mjekësore duhet të theksojnë përvetësimin e shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve nga studentët, po aq sa përvetësimi i njohurive (Rabinowitz, 2001).

Gjatë dekadave të fundit të qasjes tradicionale të mësimdhënies janë vënë në pikëpyetje dhe kanë qenë kontestuar nga koncepti i të mësuarit aktiv. Mësimi aktiv është "çdo gjë që përfshin studentët si ti bëjnë gjërat dhe të menduarit për gjërat që po bëjnë" (Bonwell, 1991). Vetë-perceptimi është komponenti përfundimtar kryesor i mësimin aktiv, dhe ndodh kur nxënësit mendojnë për atë që kanë mësuar dhe si po mësojnë. Perceptimi mund të ndodhë vetëm (vetë-perceptim) ose me studentë të tjerë. Perceptimi është një komponent i rëndësishëm sepse si qenie njerëzore, ne kemi aftësinë për të ndryshuar vetën tonë duke menduar për idetë dhe përvojat tona. Megjithatë, kur ne perceptojmë mbi vetën tonë idetë dhe përvojat mund ta ndryshojmë mendimin tonë për atë që na nevojitet në jetën profesionale (Bonwell, 1991).

Veçanërisht, ky lloj perceptimi ndikon në mënyrën se si mendojmë për detyrat që kryejmë dhe si ne ndryshojmë dhe përmirësojmë ato detyra për të kryer punën (Dewey, 1997).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

3.1 Objektivat hulumtuese

Ky hulumtim ka vlerë dhe rëndësi shumë të madhe pasi që po realizohet për herë të parë në Kolegjin UBT. Si synim të mostrës sonë kemi gjeneratën e parë të studentëve të fakultetit të infermierisë, të cilët aktualisht janë absolvent, më saktësisht në prag të diplomimit të tyre. Me anë të rezultateve që do të fitohen nga ky hulumtim do të kuptojmë perceptimin për nivelin e kompetencave dhe sa kanë arritur të aftësohen studentët e fakultetit të infermierisë gjatë tri viteve të studimit. Rezultatet e këtij hulumtimi do t'i shërbejnë Kolegjit, Rektorit, Dekanit dhe të gjithë atyre që udhëheqin një degë fakulteti, për të parë se në cilat pika duhet të fokusohen ata si profesionist për të aftësuar më mirë gjeneratat e ardhshme. Për realizimin e këtij studimi, kemi zhvilluar tri objektiva hulumtuese, të cilat janë si në vijim:

1. Të gjejmë nivelin e pëceptimit të absolventëve të programit të infermierisë për nivelin e kompetencave të tyre për të dalur në treg të punës.
2. Të gjejmë nivelin e perceptimit të absolventëve të fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT për njohurit teorike dhe praktike të fituara gjatë tre viteve të studimit.
3. Të gjejmë nivelin e perceptimin të absolventëve të fakultetit të Infermierisë të kolegjit UBT për aftësitë e tyre për të trajtuar pacientët në repartet specifike.

3.2 Synimi kryesor

Synimi kryesor i këtij hulumtimi është të gjejmë dhe të përshkruajmë perceptimin e absolventëve të fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT rreth nivelit të përgaditjes së tyre për tregun e punës. Me anë të këtij hulumtimi do të kuptojmë me saktësi nivelin e perceptimin e absolventëve se sa kanë fituar njohuri teorike dhe praktike gjatë viteve të studimit. Gjithashtu edhe nivelin e perceptimit të absolventëve se sa janë të aftë të trajtojnë pacientë në reparte specifike me nevoja të ndryshme, pasi që kanë mbaruar studimet.

3.3 Hipotezat

Gjatë përpilimit të projektit hulumtues dhe analizimit të literaturës janë zhvilluar tri hipoteza, të cilat janë:

1. Absolventët e fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT kanë mjaftueshëm kompetenca për të dalur në treg të punës.
2. Absolventët e fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT kanë fituar mjaftueshëm njohuri praktike dhe teorike gjatë tre viteve të studimit.
3. Absolventët e fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT kanë mjaftueshëm aftësi për të trajtuar pacientët në repartet specifike.

4. MATERIALI DHE METODAT

4.1 Konceptualizimi i hulumtimit

Ky hulumtim është realizuar me anë të studimit ndërsektorial, i cili përdoret për të zbuluar prevalencën e një rezultati ose ekspozimi në një grup të caktuar individësh. Studimet ndërsektoriale i lejojnë hulumtuesit të gjenerojnë hipoteza që mund të testohen duke përdorur metoda të tjera sasiore, siç janë studimet e PKR dhe kohort.

4.2 Mostra

Mostrën e përgjithshme të këtij studimi e përbëjnë 280 absolventë të fakultetit të Infermierisë në kolegjin UBT, ku prej tyre vetëm 71 janë shprehur të gatshëm t'i përgjigjen pyetësorit për matjen e nivelit të përceptimit të absolventëve të programit të infermierisë për nivelin e kompetencave të tyre për të dalur në treg të punës.

Tabela 1: Statistika deskriptive për moshën

	N	Minimum	Maksimum	M	DS
Mosha	71	20	39	22.07	3.209
Valid N (listwise)	71				

Në këtë studim morrën pjesë 71 persona. Mosha mesatare ishte 22.07 vjeç.

Tabela 2: Statistika deskriptive për gjininë

		Frekuenca	Përqindja
Gjinia	Mashkull	4	5.6
	Femer	67	94.4
	Total	71	100.0

Nga 71 pjesëmarrës, 67 pjesëmarrëse ishin femra ndërsa 4 prej tyre ishin meshkuj.

4.3 Instrumenti

Të dhënat janë grumbulluar me anë të pyetësorit të vetë-dizajnuar, i cili është i bazuar në pyetësorin "Përgaditja akademike dhe klinike e studentëve të vitit të fundit akademik në drejtimin Logopedi"- Kelly (1997). Pyetësori është përkthyer dhe përshtatur për fushën e infermierisë dhe është lansuar në mënyrë online (me anë të google forms).

Tabela 3: Analiza e Cronbach's Alpha

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.895	18

Pyetësori është përdorur për të matur perceptimin e studentëve për të dalur në treg të punës pas diplomimit. Për të matur perceptimin e studentëve për të dalur në treg të punës pas diplomimit ky pyetësor përmban 18 pyetje të cilat kanë treguar një shkallë me një konsistencë të mirë, siç përcaktohet edhe nga vlera e Cronbach's Alfa prej 0.89. Cronbach's Alfa tregon qëndrueshmërinë e brendshme, se sa të lidhura janë një grup pyetjesh si një grup.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Për analizimin e të dhënave është përdorur Paketa Statistike për Shkenca Sociale, SPSS, përkatësisht versioni 21. Llojet e analizës të cilat janë realizuar në këtë hulumtim janë: analiza e besueshmërisë së pyetësorit Cronbach's Alpha, statistikat deskriptive, analiza e korelacionit, analiza e regresionit dhe analiza e ANOVA-s.




Figura 1: Njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri.

Në këtë grafikoni kemi të paraqitur përgjigjet e studentëve rreth njohurive praktike që trajton infermiera, nga 71 pjesëmarrës 8.5% u përgjigjën se kanë pak njohuri, 74.6% shprehën se kanë mjaftueshëm njohuri dhe 16.9% kanë shumë njohuri.




Figura 2: Praktikat e zhvilluara gjatë këtyre tre viteve akademike.

Në pyetjen se sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike 2.8% e studentëve kanë shprehur se njohuritë teorike që kanë nuk janë aspak të mjaftueshme, 25.4% pak të mjaftueshmë, 64.8% mesatarisht të mjaftueshme dhe 7.0% shumë të mjaftueshme.




Figura 3: Sa ndihen të përgaditur të dilni në treg të punës pas diplomimit?

Në Grafikonin 3 kemi të paraqitur perceptimin e studentëve se sa ndihen të përgatitur të dalin në treg të punës pas diplomimit. Bazuar nga rezultatet 2.8% e studentëve nuk ndihen të përgaditur aspak, 15.5% e studentëve ndihen pak të përgaditur, 67.6% e studentëve ndihen mjaftueshëm të përgatitur dhe 14.1% shumë të përgatitur.

Nëse kthehemi tek hipotezat, hipoteza e parë ishte se absolventët e fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT kan mjaftueshëm kompetenca për të dalur në treg të punës. Ndërsa hipoteza e dytë se absolventët e fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT kanë fituar mjaftueshëm njohuri praktike dhe teorike gjatë tre viteve të studimit.

Atëherë bazuar nga rezultati i përgjigjeve të studentëve, nga të gjitha grafikonet shohim se 74.6% e studentëve kanë marrë mjaftueshëm njohuri teorike. 64.8% e studentëve shprehën se praktikën kanë qenë mesatarisht të mjaftueshme gjatë këtyre tri viteve akademike dhe 67.6% e studentëve ndihen mjaftueshëm të përgatitur për të dalur në treg të punës. Ku do të thotë se këto rezultate përputhen me dy hipotezat tona të para. Një studim longitudinal i bërë nga Ensslen (2013) tregon se praktika e mbështetur në evidencë si dhe trajnimet e ndryshme profesionale janë metoda shumë të mira që studentët e vitit të fundit akademik të shkencave shëndetësore të kenë perceptim pozitiv për të dalë në treg të punës. Po ashtu një hulumtim i

bërë nga Insalaco (2007) tregon se studentët kishin perceptim të mirë ndaj punës në grupe në veçanti.

Tabela 4: Statistika deskriptive e reparteve

<i>Repartet</i>	<i>Aspak i aftë</i>	<i>Pjesërisht i aftë</i>	<i>Mesatarisht i aftë</i>	<i>Shumë i aftë</i>
Emergjencia	9.9	33.8	47.9	8.5
Pediatria	8.5	25.4	57.7	8.5
Gjinekologjia	16.9	36.6	35,2	11,3
Onkologjia	19.7	33.8	39.4	7.0
Kardiologjia	15.5	31.0	38.8	15.5
Pulmologjia	9.9	45.1	38.0	7.0
Otorinolaringologjia	22.5	43.7	31.0	2.8
Dermatologjia	25.4	32.4	33.8	8.5
Radiologjia	11.3	31.0	35.2	22.5
Psikiatria	29.6	32.4	31.0	7.0

Bazuar nga rezultatet e analizës deskriptive rreth klasifikimit të njohurive për të ushtruar profesionin në reparte të ndryshme, shihet se kemi pasur gjithsej dhjetë reparte, të tilla si: reparti i Emergjencës, Pediatriisë, Gjinekologjisë, Onkologjisë, Kardiologjisë, Pulmologjisë, Otorinolaringologjisë, Dermatologjisë, Radiologjisë dhe Psikiatriisë. Studentët shprehën se ndihen më pak të aftë të punojnë në repartin Otorinolaringologjisë ku 22.5% thanë se nuk janë aspak të aftë, në repartin e Dermatologjisë 25.4% nuk janë aspak të aftë dhe me përqindje më

të madhe, më saktësisht 29.6% nga studentët nuk ndihen aspak të aftë të punojnë në repartin e Psikiatrisë.

Sa i përket reparteve tjera studentët ndihen pjesërisht dhe mesatarisht të aftë, me përqindje më të madhe rreth 57.7% ndihen mesatarisht të aftë të punojnë në repartin e pediatriisë. Repartet të cilat studentët u shprehën shumë të aftë të punojnë janë kardiologjia vetëm 15.5% dhe radiologjia vetëm 22.5%. Bazuar nga *Tabela 4*, mund te shohim se studentët nuk ndihen krejtësisht të paaftë as plotësisht të aftë për të ushtruar profesionin e tyre, por përgjigjet variojnë në mes të pjesërisht dhe mesatarisht të aftë. Si pëfundim hipoteza e tretë se absolventët e fakultetit të infermierisë të kolegjit UBT ndihen mjaftueshëm të aftë të trajtojnë pacientët në repartet e ndryshme mbështetet nga të dhënat tona. Një studim nga Plexico (2017), tregon se ankthi i studentëve ulet dhe vetëbesimi rritet dukshëm pasi studentët marrin trajnime adekuate për të filluar punën pas diplomimit, si dhe ata ndihen më të sigurtë.

Tabela 5: Statistika deskriptive e intervenimeve

<i>Variablat</i>	<i>Aspak i aftë</i>	<i>Pjesërisht i aftë</i>	<i>Mesatarisht i aftë</i>	<i>Shumë i aftë</i>
Pastrimi i plagëve	1.4	9.9	52.1	36.6
Injektimi	9.9	50.7	50.7	39.4
Intervenim kirurgjikal	12.7	46.5	33.8	7.0
Procesi i lindjes	23.9	31.0	43.7	1.4

Në *Tabelën 5*, kemi rezultatet e të dhënave nga studentët se sa janë të aftë të bëjnë pastrimin e plagëve, të injektojnë, të intervenojnë në proces kirurgjikal dhe të ndihmojnë në proces të lindjes pasi kanë përfunduar studimet. Bazuar në këto rezultate atëherë shohim se vetëm 1.4% e studentëve nuk janë aspak të aftë të bëjnë pastrimin e plagëve, 9.9% janë pjesërisht të aftë, 52.1% mesatarisht të aftë dhe 36.6% shumë të aftë.

Sa i përket injektimit, 9.9% treguan se nuk janë aspak të aftë, 50.7% pjesërisht të aftë, 50.7% mesatarisht të aftë dhe 39.4% shumë të aftë. Në intervenime kirurgjikale 12.7% u shprehën se

nuk kanë aspak aftësi, 46.5% kanë pjesërisht aftësi, 33.8% mesatarisht dhe vetëm 7% janë shumë të aftë. Ndërsa të ndihmojnë një proces të lindjes 23.5% e studentëve nuk janë aspak të aftë, 31% janë pjesërisht të aftë, 43.7% mesatarisht të aftë dhe vetëm 1.4% shumë të aftë.

Tabela 6: Analiza e korrelacionit

		Klasifikoni njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri?	Sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike?	Sa ndiheni të përgaditur të asistoni në një intervenim kirurgjikal?	Sa ndiheni të përgaditur të dilni në treg të punës pas diplomimit?
Klasifikoni njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri?	r	1			
Sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike?	r	.158	1		
Sa ndiheni të përgaditur të asistoni në një intervenim kirurgjikal?	r	.320**	.405**	1	
Sa ndiheni të përgaditur të dilni në treg të punës pas diplomimit?	r	.287*	.461**	.471**	1

Nga rezultatet shihet se niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermiera ka ndërlidhje të fortë pozitive me faktin se sa këta studentë ndihen të përgaditur të asistojnë në një intervenim kirurgjikal ($r=.320$, $p=.007^{**}$). Po ashtu ka ndërlidhje të moderuar pozitive në mes të nivelit të njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermiera, ndërsa ka ndërlidhje të fortë pozitive me atë se sa ndihen të përgaditur të dalin në treg të punës studentët pas diplomimit ($r=.287$, $p=.015^*$). Gjithashtu ndërlidhje e fortë pozitive është gjetur edhe në mes të asaj se sa kanë qenë të mjaftueshme orët e zhvilluara praktike gjatë këtyre tre viteve akademike me atë se sa ndihen të përgaditur të asistojnë në një intervenim kirurgjikal ($r=.405$, $p=.000^{**}$).

Tabela 7: Analiza e regresionit

ANOVA ^a						
Modeli		Totali	df	M	F	Sig.
1	Regression	7.431	2	3.716	11.909	.000 ^b

a. Variabla e varur: Sa ndiheni të përgaditur të dilni në treg të punës pas diplomimit ?

b. Parashikuesi: Sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike? , Klasifikoni njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri ?

Koeficientët ^a						
Modeli		Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e standardizuar		
		B	Std. Error	Beta	t	Sig.
	Klasifikoni njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri ?	.281	.135	.219	2.076	.042
	Sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike?	.440	.109	.426	4.032	.000

R²: 509^a

Analiza e regresionit është përdorur për të parë nëse niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermiera dhe fakti se sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara në praktikë klinike, gjatë këtyre tre viteve akademike ndikojnë atë se sa ndihen të përgaditur të dalin në treg të punës studentët pas diplomimit. Modeli regresiv është signifkant me $p=.000$, ku shpjegohet nga variablat e pavarura të lartpërmendura. Ky model shpjegon 50% të variancës. Këtu shihet se niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermiera dhe fakti se sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike ndikojnë atë se sa ndihen të përgaditur të dalin në treg të punës studentët pas diplomimit.

. Tabela 8: Analiza e Anovës

ANOVA						
		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Sa ndiheni të përgaditur të asistoni një proces të lindjes?	Between Groups	14.869	3	4.956	9.905	.000
	Total	48.394	70			

Nga rezultatet e analizës së Anovës, shihet që kemi dallime signifikante në mes të aftësive për të punuar në repartin e Gjinekologjisë dhe gadishmërisë së po këtyre studentëve që të asistojnë në një proces të lindjes ($p=.000$).

Tabela 9: Analiza e Anovës2

ANOVA						
		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Klasifikoni njohuritë e juaja për të pastruar plagët?	Between Groups	5.785	3	1.928	4.760	.005
	Total	32.930	70			
Klasifikoni njohuritë e juaja për të injektuar?	Between Groups	7.506	3	2.502	7.876	.000
	Total	28.789	70			

Nga rezultatet e analizës së Anovës shihet që kemi dallime signifikante në mes të aftësive për të punuar në repartin e Emergjencës dhe njohurive së po këtyre studentëve për të pastruar plagët ($p=.005$). Po ashtu është gjetur dallim signifikant edhe në mes të aftësive për të punuar në repartin e Emergjencës dhe njohurive së po këtyre studentëve për të injektuar ($p=.000$).

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bazuar nga rezultatet e fituara nga ky hulumtim, mund të konkludojmë se absolventët e Fakultetit të Infermierisë të kolegjit UBT kanë mjaftueshëm njohuri për çështjet që i trajton fusha e infermierisë. Praktikat e zhvilluara gjatë këtyre tri viteve akademike sipas tyre janë mesatarisht të mjaftueshme. Ndërsa sa i përket perceptimit të tyre se sa ndihen të përgatitur të dalin në treg të punës pasi të diplomojnë shumica e studentëve ndihen mjaftueshëm të përgatitur.

Repartet në të cilat ndihen më pak të aftë të punojnë pas diplomimit të tyre janë: reparti i otorinolaringologjisë, reparti i dermatologjisë dhe ai i psikiatrisë. Repartet të cilat ata ndihen mjaftueshëm të aftë të punojnë janë: reparti i emergjencës, reparti i pediatriisë, reparti i onkologjisë dhe reparti i pulmologjisë. Ndërsa më shumë të aftë ndihen të punojnë në repartin e gjinekologjisë dhe kardiologjisë.

Sa i përket intervenimeve të cilat ata janë të aftë t'i bëjnë pas diplomimit, studentët treguan më pak aftësi në asistim në intervenime kirurgjikale dhe në proceset e lindjes, ndërsa ndihen më shumë të aftë të pastrojnë plagët dhe të injektojnë. Niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermiera ka ndërlidhje me atë se sa ndihen të përgaditur të dalin në treg të punës studentët pas diplomimit. Gjithashtu niveli i njohurive teorike për të gjitha çështjet që trajton infermiera dhe fakti se sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktike gjatë këtyre tre viteve të studimeve ndikojnë atë se sa ndihen të përgaditur të dalin në treg të punës studentët pas diplomimit.

Si përfundim mund të rekomandojmë që:

1. Kolegji të ofrojë më shumë orë praktike.
2. Zhvillimi i praktikës të jetë i barabartë në të gjitha repartet.
3. Të ofrohen trajnime për injektime dhe pastrim të plagëve.
4. Të ofrohen trajnime për asistim në intervenime kirurgjikale.
5. Të ofrohen trajnimë për asistim në proces të lindjes.

REFERENCAT

1. Akiko Fuse (2018), Needs of students seeking careers in communication sciences and disorders and barriers to their success, *Journal of Communication Disorders*, 72, pp. 40-53.
2. ASSOCIATION OF AMERICAN MEDICAL COLLEGES (2001), Graduation Questionnaire.
3. Berisha, A. (2018). Studentët e papërgatitur apo punëdhënësit shumë kërkues?
4. Björk. (2001). Preparing the next generation of superintendents: Integrating formal and superintendence: Advances in research and theories of school management and educational policy, pp. 19-54. Greenwich, CT: JAI Press.
5. Bond, H. & Spurr, D. (1999). Learning practical skills Educating Beginning Practitioners: Challenges for Health Professional Education, pp. 189-196.
6. Bonwell, C. C., & Eison, J. A. (1991). Active learning: Creating excitement in the classroom. ASHE-ERIC Higher Education Report 1, pp. 2. Washington, D.C.: George Washington University.
7. David A. Shapiro & Billy T. Ogletree & W. Dale Brotherton (2002), Graduate students with marginal abilities in communication sciences and disorders: prevalence, and solutions. *Journal of Communication Disorders*, 35, pp.421-451.
8. Deborah Insalaco & Digna Santiago 2007, *Journal of Communication Disorders*, 40(3).
9. Dewey, J. (1997). Experience and education. New York, NY: Touchstone.
10. Duch, B. J., Groh, S. E., & Allen, D. E. Eds. (2001). The power of problem-based learning. Sterling, VA: Stylus.
11. Ensslen, Anysia J. (2013). Experiences of speech-language pathology graduate students: An exploratory phenomenological study. Theses and Dissertations, Educational Leadership Studies.
12. Fraser, R.C. (1991) Undergraduate medical education: present state and future needs, *British Medical Journal*, 303, pp. 41–43.
13. Fink, L. D. (2003). Creating significant learning experiences: An integrated approach to designing college courses. San Francisco, CA: Jossey-Bass.
14. Flexner, A. (1925) *Medical Education – A Comparative Study* (New York, Macmillan).
15. Forsyth, B. H., & Lessler, J. T. (1991). Cognitive laboratory methods: A taxonomy. In P. P. Beimer, R. M. Groves, L. E. Lysber, N. A. Mathiowetz & S. Sudman (Eds.), *Measurement errors in surveys* (pp. 393-418). New York: Wiley.

16. Greenlick, M.R. (1995) Educating physicians for the 21st century, *Academic Medicine*, 70, pp. 179–185.
17. Instituti për Hulumtime Zhvillimore, Riinvest. (2003).
18. Kelly, E. M., Martin, J. S., Baker, K. E., Rivera, N. I., Bishop, J. E., Krizizke, C. B., Stealy, J. M. (1997). Academic and clinical preparation and practices of school speech-language pathologists with people who stutter. *Language, Speech, and Hearing Services in Schools*, 28, 195-212.
19. Laura W. Plexico & Allison M. Plumb & Daniel E. Phillips (2017). Speech-Language Pathology Student Anxiety, Expectations, and Needs During Clinical Practicum, *Teaching and Learning in Communication Science and Disorders*, 1(2).
20. Lilach Eyal & Robert Cohen (2006). Preparation for clinical practice: a survey of medical students and graduates' perceptions of the effectiveness of their medical school curriculum, *Medical teacher*, 28(6), e161-e170.
21. Mannix, J., Faga, P., Beale, B., & Jackson, D. (2006). Towards sustainable models for clinical education in nursing: An on-going conversation. *Nurse Education in Practice*, 6, 3-11.
22. Meyers, C., & Jones, T. B. (1993). *Promoting active learning: Strategies for the college classroom*. San Francisco, CA: Jossey-Bass.
23. Nestor-Baker, N., & Hoy, W. (2001). Tacit knowledge of school superintendents: Its nature, meaning, and content. *Educational Administration Quarterly*, 37(1), 86-129.
24. Rabinowitz, H.K., Babbott, D., Bastacky, S., Pascoe, J.M., Patel, K.K., Pye, K.L., Rodak, J., Veit K.J. & Wood, D.L. (2001) Innovative approaches to educating medical students for practice in a changing health care environment: the National UME-21 Project, *Academic Medicine*, 76, pp. 587–597
25. Rose, M., & Best, D. (2005). *Transforming practice through clinical education, professional supervision, and mentoring*. New York: Elsevier Churchill Livingstone.
26. Stech, E. L., Curtiss, J. W., Troesch, P. J., & Binnie, C. (1973). Clients' reinforcement of speech clinicians: a factor-analytic study. *ASHA*, 15(6), 287-289.
27. Westerveld, M. & Garvis, S. (2014), Speech pathology students' perceptions of workplace-based volunteer placements in a school setting. *Journal of Teaching and Learning for Graduate Employability*, 5(1).
28. Wilkerson, L., & Gijsselaers, W. H. (Eds.). (1996). *Bringing problem-based learning to higher education: Theory and practice*. New directions for teaching and learning, no. 68. San Francisco, CA: Jossey-Bass.

SHTOJCAT

Të nderuar studentë, ky pyetësor ka për qëllim që të arrijmë të vlersojmë përceptimin tuaj për të dalur në treg të punës pas diplomimit. Çdo informacion personal që jepni do të jetë konfidencial, ju lutemi të na jepni përgjigje sa më të sinqerta. Nëse keni ndonjë paqartësi apo pyetje, ndjehuni të lirë të na pyetni.

Mosha : _____

Gjinia(rretho) : a) Femër b) Mashkull

1. Klasifikoni njohuritë teorike për të gjitha çështjet që trajton Infermieri ?

- a) Nuk kam njohuri aspak
- b) Kam pak njohuri
- c) Kam mjaftueshëm njohuri
- d) Kam shumë njohuri

2. Sa kanë qenë të mjaftueshme muajt e zhvilluara praktikë gjatë këtyre tre viteve akademike?

- a) aspak të mjaftueshme
- b) pak të mjaftueshme
- c) mesatarisht të mjaftueshme
- d) shumë të mjaftueshme

3. Klasifikoni njohuritë e juaja për matje të tensionit dhe shtypjes së gjakut?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

4. Klasifikoni njohuritë e juaja për të pastruar plagët?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

5. Klasifikoni njohuritë e juaja për të injektuar?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

6. Klasifikoni njohuritë e juaja për të punuar në repartin e Emergjencës?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

7. Klasifikoni njohuritë e juaja për të punuar në repartin e Pediatriisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

8. Klasifikoni njohuritë e juaja për të punuar në repartin e Gjinekologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

9. Klasifikoni njohuritë e juaja për të punuar në repartin e Onkologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

10. Klasifikoni njohuritë e juaja për të punuar në repartin e Kardiologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

11. Klasifikoni njohuritë tuaja për të punuar në repartin e Pulmologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

12. Klasifikoni njohuritë tuaja për të punuar në repartin e Otorinolaringologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

13. Klasifikoni njohuritë tuaja për të punuar në repartin e Dermatologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

14. Klasifikoni njohuritë tuaja për të punuar në repartin e Radiologjisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

15. Klasifikoni njohuritë tuaja për të punuar në repartin e Psikiatrisë?

- a) Aspak i aftë
- b) Pjesërisht i aftë
- c) Mesatarisht i aftë
- d) Shumë i aftë

16. Sa ndiheni të përgaditur të asistoni në një intervenim kirurgjikal ?

- a) Aspak i përgaditur
- b) Pak i përgaditur
- c) Mjaftueshëm i përgaditur
- d) Shumë i përgaditur

17. Sa ndiheni të përgaditur të asistoni një proces të lindjes?

- a) Aspak i përgaditur
- b) Pak i përgaditur
- c) Mjaftueshëm i përgaditur
- d) Shumë i përgaditur

18. Sa ndiheni të përgaditur të dilni në treg të punës pas diplomimit ?

- a) Aspak i përgaditur
- b) Pak i përgaditur
- c) Mjaftueshëm i përgaditur
- d) Shumë i përgaditur